

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**mbajtur më 21.3.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Z. Petrushevski shpjegoi se gjatë leximit të propozimit të Rendit të ditës do të bëjë një korrigjim, përkatësisht do të tërheqë Pikën 3 sepse dy transmetuesit e kanë paguar tarifën vjetore dhe nuk është e nevojshme të merren vendime për heqjen e lejes për transmetim në televizion dhe radio.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi korrigjimin e mëposhtëm të:

**RENDIT TË DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 13.3.2023.
2. Draft-raporti vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.
3. Propozimet për ndërprerjen e procedurave të inicuar për heqjen e lejeve për transmetim në televizion dhe radio.
4. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR RADIO PRO-FM nga Gostivari.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Larja e automjeteve .
6. Informacion mbi pagesën e anëtarësimit vjetor për EPRA për vitin 2023.
7. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 10- të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 13.3.2023, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Z. Petrushevski sqaroi se Raporti vjetor i propozuar për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022 është në Draft formë, dhe së shpejti do të propozohet si draft dokument në seancë, i cili më pas do t'i dorëzohet Kuvendit. Ai theksoi se nëse anëtarët e Këshillit kanë vërejtje apo propozime, do të ketë kohë të mjaftueshme për t'i dorëzuar.

Z. Trajçevski shpjegoi Draft-raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022. Ai shpjegoi se përgatitja e këtij Raporti është në përputhje me detyrimin ligjor të Agjencisë për t'i dhënë llogari Kuvendit për punën e saj, rrjedhimisht edhe këtë dokument, i cili është ende draft version, përmban një pasqyrë të të gjitha aktiviteteve që janë realizuar gjatë vitit 2022. Ai ka shpjeguar se për 7 ditë me vërejtje të mundshme dhe korrigjime të pranueshme do të vihet në Rend dite si propozim dhe si i tillë do t'i dorëzohet Kuvendit. Ai theksoi se në pjesën e parë të Raportit janë paraqitur të gjitha mbikëqyrjet që janë bërë mbi transmetuesit lidhur me përmbushjen e detyrimeve programore dhe administrative. Janë zbatuar mbi 300 mbikëqyrje, nga të cilat pjesa më e madhe, pra 197, janë mbikëqyrje programore mbi transmetuesit. Duke pasur parasysh se vitin e kaluar janë mbajtur zgjedhjet për kryetarë komunash në Mavrovë dhe Rostushë dhe në Qendër Zhupë, si dhe zgjedhje për anëtarë të Këshillit të Komunës së Tetovës, Agjencia ka ndërmarrë edhe aktivitete lidhur me këtë proces zgjedhor. Monitorimi i përfaqësimit zgjedhor është vendosur që të bëhet vetëm në bazë të peticioneve sepse zgjedhjet janë bërë vetëm në tri komuna, kurse në një komunë ka qenë vetëm për anëtarë të Këshillit. Gjatë fushatës zgjedhore është kryer monitorimi i reklama politike me pagesë, e cila përfshinte televizionin kombëtar 21-M dhe televizionet rajonale nga Tetova - Koha, Pollogu dhe Kiss&Menada. Gjithashtu, gjatë kohës së heshtjes zgjedhore është realizuar monitorimi mbi punën e gjithsej 16 transmetuesve, 13 prej tyre në nivel shtetëror dhe tre në nivel rajonal. Duke vepruar në përputhje me "Rekomandimin e Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Pluralizmin në Media dhe Transparencën e Pronësisë së Medias", vitin e kaluar për herë të katërt u botua "Pronësia e Medias në 2022", i cili përmban të dhëna për pronarët e transmetuesve dhe botuesit e medias së shkruar. Këtë vit, pasi u konstatua se nuk ka pengesa ligjore, u miratua ndryshimi i strukturës së pronësisë së dy transmetuesve. Agjencia ishte veçanërisht aktive në fushën e arsimimit mediatik, si dhe në sferat e sigurimit të qasjes (aksesit) në programet për personat me aftësi të kufizuara shqisore dhe çështjet gjinore. Për herë të katërt, së bashku me Rrjetin për arsimimin mediatik u organizuan Ditët e arsimimit mediatik 2022, më pas u organizua një punëtori kushtuar nevojave mediatike të personave me aftësi të kufizuara, Agjencia mori pjesë në procesin e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2030, nisi përgatitjen e një ueb faqe të veçantë për gjininë dhe median, etj. Në vitin 2022, Agjencia ka dhënë një leje për transmetim televiziv në nivel lokal, në zonën e Kumanovës. Për të konstatuar nëse ata i përmbushin detyrimet e përcaktuara për ta në LSHMAAV, janë kryer 169 mbikëqyrje mbi punën e operatorëve dhe tetë mbi punën e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës. Gjashtë mbikëqyrje janë kryer mbi botuesit e medias së shkruar. Për shkak të mos respektimit të Ligjit

për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Ligjit për Media dhe akteve nënligjore nga transmetuesit dhe operatorët, gjatë vitit janë shqiptuar 103 masa. Prej tyre, 79 kanë qenë Paralajmërime publike, tetë procedura për kundërvajtje, 10 procedura për zgjidhje-procedura për dhënien e urdhërpagesës për kundërvajtje, dy Vendime për heqjen e lejeve dhe katër Aktvendime për fshirje nga regjistri i transmetuesve. Në vitin 2022, Agjencia përpiloi Analizën vjetore të Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mati shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë e programeve të transmetuesve dhe përpiloi analiza dhe studime të tjera në lidhje me çështje të rëndësishme në këtë fushë. Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, ai shpjegoi se vitin e kaluar përfaqësuesit e Agjencisë kanë marrë pjesë aktive në punën e platformave, grupeve dhe organizatave ndërkombëtare rregullatore dhe janë mbajtur takime bashkëpunimi dhe bilaterale me organet rregullatore në Evropë, veçanërisht me organet rregullatore nga rajoni. Me rastin e 25 vjetorit të themelimit, më 10 dhe 11 nëntor, Agjencia organizoi takimin rajonal “Organet rregullatore të medias në mjedisin e ri mediatik – si të garantohet pavarësia”, ku morën pjesë përfaqësues të organeve rregullatore të medias nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Shqipëria dhe Bullgaria. Krahas këtij Draft-raporti, në fund të dokumentit është një pasqyrë e detajuar e të gjitha masave që Agjencia ka shqiptuar gjatë vitit, Raport për zbatimin e planit për mbikëqyrje programore për vitin 2022 dhe Raport për zbatimin e planit financiar për vitin 2022.

Z. Fidanoski tha se diskutimi për këtë temë në këtë pjesë të vitit është bërë vite më parë sepse deri më 31 mars duhet të dorëzohet në Kuvend Raporti vjetor për punën e Agjencisë për vitin 2022. Ky dokument paraqet një përmbledhje të të gjitha aktiviteteve që Agjencia ka pasur në realizimin e detyrimeve dhe detyrave të saj ligjore. Vetë vëllimi i Raportit tregon se ASHMA-ja ka pasur një numër të madh aktiviteteve në disa fusha, të cilat janë kompetenca ligjore, por edhe jashtë tyre. Kjo tregon se rregullatori e kryen punën e tij në mënyrë adekuate dhe konsideron se Raporti është përgatitur në mënyrë profesionale dhe korrekte nga Shërbimi Profesional. Ai është gjithëpërfshirës, i detajuar dhe mund të përmbajë një sërë informacionesh që Këshilli ose palët e interesuara nga jashtë mund të dëshirojnë t'i kërkojnë. Ai deklaroi se do të japë mbështetje. Ai shpjegoi se do të komentonte një fenomen për të cilin, megjithëse nuk ka asnjë detyrim ligjor për operatorët e rrjeteve publike të komunikimit, mbi të gjitha operatorët më të mëdhenj, shpeshherë në ofertën e tyre për transmetimin e kanaleve televizive nuk kanë përmbajtje me titra, nuk do të thotë përmbajtje që transmetohet drejtpërdrejt, por për përmbajtje filmash. Mendimi i tij është se duhet ta korrigjojnë këtë sa më parë sepse është e papërshtatshme që shikuesve t'u ofrohet përmbajtje në një paketë programore, ndërsa jo të gjitha gjërat ruhen. Në këtë shtet gjuha zyrtare është maqedonishtja, zyrtarisht përdoret edhe gjuha shqipe, e nga ana tjetër për përmbajtje të caktuara nuk ka titra në këto dy gjuhë, pavarësisht se kush si zgjedh. Ai mendon se kjo është mangësi e vetë operatorëve, i cili beson se në të ardhmen do të korrigjohet, sepse kjo do ta bënte shumë më të mirë ofertën e programit dhe për shfrytëzuesit e fundit. Së fundi, në lidhje me faqen 51 të Raportit për Kontestet juridike kundër akteve të miratuara nga Agjencia, ai pyeti se për çfarë konkretisht bëhet fjalë për padinë nga ana e TV Kanal 5?

Z. Trajçevski u përgjigj se bëhet fjalë për një mbikëqyrje që është bërë dhe është iniciuar procedurë për kundërvajtje në lidhje me plasim (reklamim) produktesh.

Z. Ajdini shpjegoi se ka shqyrtuar Draft-Raportin, të cilin e konsideron në përmbajtje të pasur dhe mjaft i gjerë me aktivitete që kanë të bëjnë me punën e Agjencisë. Janë pasqyruar të gjitha detyrimet që ishin planifikuar dhe përmbushur në vitin 2022. Ai deklaroi se në këtë fazë do ta mbështesë dokumentin, por lë mundësinë nëse ka vërejtje t'i paraqesë me shkrim.

Z. Petrushevski deklaroi se do të mbështesë Draft-raportin, i cili është përpiluar mirë dhe me cilësi të lartë. Nëse ka vërejtje, do t'i paraqesë në periudhën e ardhshme.

Z. Trajçevski, proceduralisht, sqaroi se kur Raporti të jetë në Draft version në seancë, do të dorëzohet dhe Raporti i revizionit nga revizor i pavarur së bashku me qëndrimin e Këshillit lidhur me Raportin.

Këshilli i Agjencisë dha pëlqimin dhe miratoi Draft-raportin vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozimet për ndërprerjen e procedurave të iniciuara për heqjen e lejes për transmetimin në televizion dhe radio, sqaroi se ky është lajm pozitiv sepse të 14 mediat për të cilat është nisur procedura për heqjen e lejes kanë paguar tarifën vjetore.

Z. Trajçevski konfirmoi se të 14 transmetuesit e kanë paguar plotësisht tarifën vjetore për licencën për transmetim në televizion dhe radio. Për këtë arsye i propozohet Këshillit që për secilin prej tyre të ndërpritet procedura e inicuar.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VALANDOVO SHPK Vallandovë, nr 08-90 datë 5.1.2015 .

Sipas faturës së (lëshuar) dhënë, transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar nr 08-100 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë, transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë nr 08-93 datë 5.1.2015 .

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO MEDISON SHPKNJP Kërçovë nr 08-104 datë 5.1.2015 .

Sipas faturës së dhënë, transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, nr. 08-64 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup nr 08-65 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e licencës për transmetim në radio Shoqërisë tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë nr 08-133 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e licencës për transmetim në televizion të Shoqërisë Tregtare me veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, komuna e Labunishtës SHPKNJP nr 08-56 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në televizion.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendimin për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e licencës për transmetim në televizion të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, nr.08-50, datë 5.1.2015 .

Sipas faturës së lëshuar, transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit televiziv .

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në televizion të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV ERA SHPKNJP Shkup nr 08-15 datë 5.1.2015 .

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në televizion.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në televizion të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP nr 08-55 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në televizion.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ARAÇINA SHPKNJP f,Haraçinë, Haraçinë, nr. 08-67, datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep nr 08-117 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në radio.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë ka miratuar Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e licencës për transmetim në televizion të Shoqatës Tregtare me veprimtari Radiodifuzive në radio TV SHUTEL SHPKNJP Shkup nr. 08-18 datë 5.1.2015.

Sipas faturës së dhënë transmetuesi i lartpërmendur ka paguar në tërësi tarifën vjetore për licencën e transmetimit në televizion.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva sqaroi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të

SHTR RADIO PRO-FM nga Gostivari. Shpjegoi se njoftimi i dorëzuar është i kompletuar dhe i rregullt. Është kërkuar pëlqim që pronësia e pronarit të këtij stacioni lokal i radios, personi juridik SHTR RADIO PRO-FM 92 EKSKLUZIV SHPKNJP Gostivar, pjesën prej 50% nga kapitali aksionar ta ndërmarrin dy personat fizikë, për të cilët nuk ka pengesa ligjore dhe këto persona të paraqiten si pronarë të transmetuesve. Për këtë arsye drejtuar Këshillit është dorëzuar propozim për miratimin e Vendimit me të cilën do të miratohet ndryshimi i planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPKNJP nga Gostivari, me tekst siç ishte propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara në strukturës e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPKNJP nga Gostivari nuk paraqitet koncentrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk bie në kundërshtim me nenet 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 5**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Larja e automjeteve. Shpjegoi se kemi të bëjmë me furnizim të rregullt që do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët. Mjetet janë paraparë në Planin financiar të Agjencisë për vitin 2023, pra do të parashihen dhe në Planin financiar për vitin 2024, sepse kontrata që do të rezultojë nga ky furnizim publik do të lidhet për një periudhë 2 vjeçare. Të gjitha informacionet e tjera të nevojshme gjenden në materialin e dhënë sipas pikës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizim të shërbimit-larje automjetesh.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: larje automjetesh është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, pra më tej do të sigurohen nga Plani financiar i Agjencisë për vitin 2024.

#### **Pika 6**

Z. Trajçevski shpjegoi Informacionin e propozuar për pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2023. Ai ka shpjeguar se sipas vendimit të EPRA, anëtarësimi vjetor i Agjencisë në EPRA për vitin 2023 është 3.600 euro. Ky informacion është standard dhe çdo vit Agjencia e dorëzon atë në Këshill në mënyrë që pagesa për anëtarësimin në EPRA të mund të kryhet në kohë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri pranoi Informacionin për pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2023 nr. 05-248/2 datë 17.3.2023.

Sektori për financa dhe logjistikë të paguajë mjetet në vlerë prej 3.600 euro për anëtarësimin vjetor të Agjencisë në EPRA për vitin 2023.

**Pika 7**

**Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-1188/20**

**29.03.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**

**Audio dhe Audiovizuale**

**Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**